

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë", Meidani: Në ç'emër flet kjo gjyka të kur populli i Kosovës proteston?
ADRESA	https://piranjat.al/politike/thaci-krasniqi-veseli-dhe-selimi-ne-kapitujt-me-te-ndritur-te-historise-i104530
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:22:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ec5aec49d000a9df878a1cc227397e107fd94a4e9d8a18ab1a378d6de71e8eb
TEKSTI	d2b74b70cbc6c740019e3cf47ed51676745a371d0a4f04e5cb8bcb5757cd7656
PAMJA	e8144881108ae28318b822781744a34ce2338c46022179439199ca602d62ce97

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4f655d73754dc85b24c9e0d7e351abfbb27083d402fbc0912d23ea6648ae6c95
E MËPARSHMJA	1bdbc4bb73d471f098913cbfb3a6bffb89e2cd9d4fafada866c4c0bf7c807e33
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4f655d73754dc85b24c9e0d7e351abfbb27083d402fbc0912d23ea6648ae6c95>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **bulevardi Në** mbajtur në takimin e zhvilluar nga **thërret t'i** pjesë në Kuvendin e degës së **mln euro,** Eno Agasi është **pas** për misionet të posaçme, Richard Grenell, reagoi **dënimit të** **norvegjezit** vazhdojnë qarkullojnë ndërsa

[POLITIKE](#)

“Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë”, Meidani: Në ç’emër flet kjo gjykatë kur populli i Kosovës proteston?

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 20:21



Ish-Presidenti i kohës së luftës së Kosovës, Rexhep Meidani, ka reaguar pas vendimit të Hagës, e cila dënoi me 81 vite burg 4 liderët e UÇK-së.

Meidani u shpreh se asnjë gjyqtar i atij trupi gjyqkues nuk i përket Kosovës e nuk e kupton atë, duke shtuar se drejtësia e munguar duhet të jepet.

“Kam qenë President i Republikës në vitet e vështira kur Shqipëria dhe populli i saj, hapën kufijtë dhe zemrën për vëllezërit e tyre shqiptarë të Kosovës që po dëboheshin nga shtëpitë dhe trojet e tyre nga milicët dhe paraushtarakët e regjimit represiv të Millosheviçit. E kam ndërjet këtë represion qysh prej viteve si pedagog i Universitetit të Prishtinës, sidomos në vitin 1981 e më pas kur jo vetëm nuk u lejuam për të vazhduar leksionet tona, por dhe na u bënë tepër të vështira kontaktet dhe komunikimet me studentët tanë. Si politikan dhe si Kryetar Shteti përjetova dhe shkallën më të lartë të egërsisë dhe represionit millosheviçian ndaj popullit shqiptar të Kosovës, që kapi nivele të skajshme gjenocidale. Aktgjykimi i sotëm në Hagë mban emrin e popullit të Kosovës, por asnjë gjyqtar i atij trupi gjyqkues nuk i përket Kosovës e nuk e kupton atë, dhe seanca nuk u mbajt as në tokën e saj. Kjo është pyetja që më munda më shumë se vetë numri i tejkjatur, pa arsye, i viteve. Në fakt, në ç’ emër flet një gjykatë e tillë, kur populli që ajo pretendon ta përfaqësojë s’ka zë e peshë brenda saj, por proteston jashtë saj apo sheshet e Kosovës? Aktgjykimi është i shkallës së parë; procesi vazhdon. Drejtësia e munguar duhet të jepet! Por, ama, duhet ta përfaqësojë vullnetin e popullit të Kosovës, jo ta zhgënjëjë atë”, shprehet Meidani në reagimin e tij.

Më tej, ish-Presidenti i kohës së luftës së Kosovës u shpreh se ajo që nuk duhet të diskutohet është konteksti historik, duke theksuar se Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e dhunës së shtetit serb, jo palë e barabartë me agresorin.

“Ajo që nuk vazhdon të diskutohet është konteksti historik: Kosova dhe populli i saj ishin viktimë e dhunës së shtetit serb, jo palë e barabartë me agresorin. Përgjegjësia individuale, nëse do të kishte, asesi nuk mund ta relativizojë atë fakt, as të vërë në pikëpyetje lirinë dhe pavarësinë që Kosova i fitoi me çmim të jetëve njerëzore, veçanërisht të rinjve të saj. Këtë e kanë pranuar këto ditë, ashtu si dhe gjatë krizës kosovare, edhe mjaft zëra perëndimorë dhe kishin e kanë të drejtë.

Personalisht mendoj se asnjë vendim gjyqësor nuk mund t’ua heqë vendin që zënë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi në një nga kapitujt më të ndritur të historisë sonë kombëtare. Në atë kohë, kur liria e Kosovës dhe paqja e rajonit ishin ende një ideal pa siguri, ata guxuan të merrnin mbi supet barrën historike për ta sjellë lirinë të populli i tyre, në një moment kur çdo gjë rrezikohej e asnjë sukses nuk ishte i garantuar. Unë e pashë atë rrezik nga afër, në kohën time si President, në pamjet e trishtueshme të debimeve me forcë dhe vrasjeve masive. Po ashtu, i kam njohur ata si djem, si luftëtarë e udhëheqës trima, me emocionin rinor dhe gatishmërinë për sakrificë, dhe aspak si njerëz të aftë për veprimtari kriminale, që u përshkruhen sot”, shkruan Meidani.

Më tej Meidani shton se Kuvendi i Kosovës ka detyrimin të vendosë që kjo gjykatë nuk meriton të vazhdojë të flasë në emër të një populli që, sipas tij, s’e njeh si të vetin.

“Sot mendoj për këta katër burra dhe për familjet e tyre, që prej gati gjatshë vjetësh mbajnë peshën e këtij procesi, teksa vazhdojnë ende luftën dhe sakrificën e tyre për të garantuar një Kosovë të lirë. Jam pranë tyre, siç kam qenë e do të jem gjithmonë.

Shqipëria e zgjodhi rrugën perëndimore që në vitet e para të demokracisë, dhe unë e kam mbështetur atë zgjedhje si qytetar e President. Por besnikëria ndaj asaj rruge nuk kërkon heshtje kur diçka na duket e padrejtë. Kërkon që t’u kërkojmë aleatëve tanë Perëndimorë që t’u përmbahen, në çdo rast dhe për çdo popull, sado i vogël qoftë ai, parimeve mbi të cilat është ngritur demokracia, mbi të gjitha: liria, barazia dhe drejtësia për të gjithë, pa përjashtim.

Prandaj besoj se këto dënime duhet të kundërshtohen deri në shkallën e fundit, me çdo mjet ligjor në dispozicion. Madje, Kuvendi i Kosovës ka detyrimin të vendosë që kjo gjykatë, në formën e sotme, nuk meriton të vazhdojë të flasë në emër të një populli që s’e njeh si të vetin”, përfundoi Meidani.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 16 Shtator20:07

Protestuesi: Ramës s'i mjaftoi shkatërrimi dhe shitja e Shqipërisë, por donte të shkatërronte edhe Dardaninë

Aktivisti Arben Kola ka mbajtur fjalën e tij në protestën e 109-të kundër kryeministrit Edi Rama, duke kritikuar qëndrimet e qever...

POLITIKE 16 Shtator19:58

Protesta e 109-të kundër qeverisë, aktivisti: Rama është Esat Pasha i ditëve të sotme

Aktivisti Mirjan Aliaj ka marrë fjalën në protestën e 109-të kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama, duke bërë ...

POLITIKE 16 Shtator19:49

“Në Hagë u luajt teatër, kjo është padrejtësi”, Dritan Goxhaj në protestë: Rama e tradhtoi Kosovën në vitin 2015! “Marre” për atë që ka bërë

Në ditën e 109-të të protestës, ish-luftëtari i UÇK, Dritan Goxhaj mbajti një fjalim shumë të fortë, pi...

POLITIKE 16 Shtator19:44

Berisha: Protesta e ka zvarritur Ramën për së gjalli çdo natë në bulevard! Ne do e mbështesim atë me të gjithë potencialin tonë

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha gjatë fjalës së mbajtur në takimin e zhvilluar nga dega lokale në Krujë, ka folu...

POLITIKE 16 Shtator19:28

Berisha: Ripërtëritja e PD-së është jetike. Ajo nuk vjen në pushtet për lavdinë e shkuar, por për vizionin për të ardhmen

Lideri i demokratëve Sali Berisha i pranishëm në Kuvendin zgjedhor të degës së PD-së në Krujë, është shpr...

POLITIKE 16 Shtator19:20

“Nesër mosbindje civile te Parlamenti” – Arben Kola: Momenti i përplasjes me qeverinë dhe deputetët e korruptuar! Vezët janë mjet demokratik

Protestat popullore kundër qeverisë së Edi Ramës kanë hyrë në ditën e tyre të 109-të, teksa revolta ndaj afëra...

POLITIKE 16 Shtator19:18

Dita e 109-të e protestës, qytetarët marshojnë nga sheshi “Skënderbej” drejt Kryeministrit, kërkojnë largimin e Edi Ramës

Ka nisur marshimi nga sheshi Skënderbej drejt Kryeministrit. Sot bëhen 109 që qytetarët protestojnë kundër qeverisë dhe...

POLITIKE 16 Shtator19:08

Berisha: Nga Kruja inaugurojmë Foltoren e Ripërtëritjes! Koha na thërret t'i japim zgjidhje kësaj gjendje dramatike

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka marrë pjesë në Kuvendin e degës së Krujës. Gjatë fjalës së mba...

POLITIKE 16 Shtator18:31

"Rama shkoi në Prishtinë për t'i bërë presion Kosovës", Peka: Gjykata Speciale u krijua nën trysni ndërkombëtare

I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, Avenir Peka, Ekspert Sigurie, deklaroi se Gjykata Speciale e Kosovës është ngritur si rezul...

POLITIKE 16 Shtator18:08

BIRN: Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magistratëve

Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kundërshtuan të mërkurën më 16 shtator projektligjin e ri për pagat e magj...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...


Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.